



Financuar nga
Bashkimi Evropian

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE #5

Menaxhimi i Kanalizimit Atmosferik në Kosovë



Promoting Universal
Access to Clean Water



**RILINDJA
GJELBËR**

SQARIM

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Rilindja Gjelbër (ish Let’s Do It Peja). Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

PËRMBLEDHJE E SHKURTË E POLITIKËS #5

Menaxhimi i kanalizimit atmosferik në Kosovë

Tetor, 2024

Përmbajtja

1. HYRJE	6
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	7
2.1 Korniza Ligjore	7
2.2 Korniza Institucionale	9
3. GJENDJA AKTUALE	11
3.1 Mbulimi i Zonës Urbane me Kanalizim Atmosferik	11
3.2 Vjetërsia dhe Gjendja e Kanalizimit Atmosferik	12
3.3 Mirëmbajtja e Kanalizimit Atmosferik	13
3.4 Resurset Financiare dhe Njerëzore të Komunave për Menaxhim të Kanalizimit Atmosferik	14
3.5 Njohuritë e Komunave për Përgjegjësinë e tyre për Menaxhimin e Kanalizimit Atmosferik	16
3.6 Bashkëpunimi me KRU	16
4. POLITIKA E REKOMANDUAR	20
Referencat	23
Shtojca: Pyetësi i Menaxhimit të Kanalizimit Atmosferik	24

Figurat

Figura 1: Mbulimi i zonës urbane me kanalizim atmosferik	8
Figura 2: Përqindja e buxhetit komunal për menaxhimin e kanalizimit atmosferik	10
Figura 3: Numri i punonjëse të komunës për menaxhimin e kanalizimit atmosferik	11

Tabelat

Tabela 1: Vjetërsia e kanalizimit atmosferik në komunat e Kosovës	9
Tabela 2: Gjendja e kanalizimit atmosferik në komuna	10
Tabela 3: Forma e organizimit të mirëmbajtjes së kanalizimit atmosferik nëpër komuna	10
Tabela 4: Bashkëpunimi i komunave me KRU në mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik	13

Shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
BE	Bashkimi Evropian
KNU	Këshilli Ndërministror për Ujëra
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
ME	Ministria e Ekonomisë
NJPM e NP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
NP	Ndërmarrje Publike
SHUKOS	Shoqata e Ujësjellësve të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ

1. HYRJJE

Kanalizimi i *ujërave të ndotura* (pas përdorimit për nevoja shtëpiake, industriale apo të tjera) si dhe i *ujërave atmosferike* (që rezultojnë nga reshjet) është me rëndësi jetike për shëndetin dhe mirëqenien e popullatës si dhe për mbrojtjen e mjedisit ujor.

Kanalizimi i ujërave të ndotura përfshinë *ujërat e ndotura urbane* dhe *ujërat e ndotura industriale*. Ujërat e ndotura urbane, sipas Direktivës së BE-së, përfshijnë ujërat e ndotura shtëpiake ose përzierjen e tyre me ujërat e ndotura industriale dhe/ose ujërat atmosferike. Ndërsa *ujërat e ndotura industriale* përfshijnë të gjitha ujërat e ndotura nga aktivitetet industriale dhe biznesore të cilat nuk janë ujëra të ndotura shtëpiake apo ujëra atmosferike.

Sistemet e kanalizimit mund të qenë të tipit të **ndarë** ose të **kombinuar (i përzier)**. Te sistemet e ndara të kanalizimit, ujërat e ndotura dhe ujërat atmosferike largohen me rrjete të veçanta të kanalizimit ndërsa te sistemet e kombinuara ujërat e ndotura bashkë me ato atmosferike largohen të përziera me një rrjet të vetëm të kanalizimit. Të dyja këto tipe i kanë përparësitë dhe mangësitë e tyre. Megjithatë kohët e fundit ndërtohen kryesisht sistemet e ndara të kanalizimit.

Në Kosovë, edhe pse kryesisht sistemet e kanalizimit janë të projektuara të tipit të ndarë, në praktikë janë në shumicën e rasteve të kombinuara/përziera si rezultat, kryesisht, i shkarkimit të ujërave atmosferike në sistemin e kanalizimit të ujërave të ndotura për shkak të mungesës së kanalizimit atmosferik në zona të caktuara urbane.

Për sa i përket menaxhimit të sistemeve të kanalizimit, me legjislacionin në fuqi¹, komunat janë përgjegjëse për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin². Në anën tjetër, me *Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit*³, shërbimet e ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të ndotura mund të ofrohen vetëm nga ofruesit e shërbimeve të cilët janë licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU); ARRU sipas këtij ligji i ka licencuar vetëm 7 Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të) që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga kjo rezulton se, **shërbimet e kanalizimit të ujërave të ndotura janë përgjegjësi e KRU-ve**, ndërsa **menaxhimi i kanalizimit atmosferik mbetet përgjegjësi e komunave**.

¹ Neni 17 i *Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale* - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

² 'Drenazhi' këtu e ka kuptimin e kanalizimit atmosferik.

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11350>

Duke pasur parasysh se ka shumë sisteme të kanalizimit që janë të tipit të kombinuar ku ujërat e ndotura kanalizohen bashkë me ujërat atmosferike, kjo e problematizon vijën ndarëse të përgjithësive që kanë KRU-të për kanalizimin e ujërave të ndotura vis-a-vis, përgjegjësive që kanë komunat për kanalizimit atmosferik.

Gjithashtu, ka indikacione që komunat nuk janë mirë dhe hollësisht të informuara për këtë ndarje të përgjegjësive që ka për pasojë mosmirëmbajtjen e rregulltë të kanalizimit atmosferik.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1 Korniza Ligjore

Aktet kryesore ligjore për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë si vijon:

- (i) Ligji Nr. 05/L - 042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit me plotësimet dhe ndryshimet e tij të bëra me Ligjin Nr. 06/L-088

Me këtë ligj, i miratuar në vitin 2016⁴ dhe amendamentuar në vitin 2019, është themeluar Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) si rregullator i pavarur ekonomik për shërbimet e furnizimit publik me ujë dhe shërbimet e kanalizimit, si dhe janë rregulluar të gjitha aspektet e rregullimit të shërbimeve të ujit, siç janë: (I) licencimi i kompanive që ofrojnë këto shërbime, (II) përcaktimi i tarifave të shërbimit që duhet të zbatohen nga këto kompani, (III) standardet e shërbimit që duhet të përmbushen nga kompanitë që ofrojnë këto shërbime (KRU-të), (IV) të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të konsumatorëve dhe KRU-ve, etj.

⁴ Legjislacioni për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe themelimin e Rregullatorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave ekziston në Kosovë prej vitit 2004, kur ishte nxjerrë Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave. Kjo Rregullore, në vitin 2008 ishte zëvendësuar me Ligjin Nr. 03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave dhe ky i fundit me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Prej vitit 2016, me miratimin e këtij ligji, vetëm shërbimet e ujit (shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit) përfshihen me ligj – pra janë larguar shërbimet e mbeturinave.

Sipas ligjit Nr. 05/L - 042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe akteve tjera nënligjore (rregulloreve) të nxjerra nga ARRU në bazë të tij, shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura i nënshtrohen rregullimit nga ARRU që nënkupton licencimin e ofruesve të këtyre shërbimeve, përcaktimin e tarifave për ofrimin e këtyre shërbimeve, si dhe përcaktimin e standardeve të cilësisë së këtyre shërbimeve.

Kanalizimi atmosferik nuk është përfshi me këtë ligj dhe rrjedhimisht nuk rregullohet sipas tij.

(ii) Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale

Ky ligj, ndër tjera, përkufizon statusin ligjor të komunave si dhe rregullon kompetencat e komunave dhe organizimin dhe funksionimin e organeve komunale.

Me këtë ligj është përcaktuar që komunat kanë kompetenca të plota për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe **drenazhin**, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes lokale.

Duke pasur parasysh se shërbimet e furnizimit me ujë si dhe ato të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza (ndotura) ofrohen nga KRU-të në pajtim me (I) legjislacionin për rregullimin e këtyre shërbimeve, dhe (II) marrëveshjet e shërbimit që kanë lidhur komunat me KRU-të sipas të cilave i autorizojnë ato për ofrimin e këtyre shërbimeve, shërbimet e drenazhit (kanalizimit atmosferik) sipas këtij ligji janë përgjegjësi ligjore e komunave.

(iii) Ligji Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vitin 2011 me Ligjin Nr. 04/L111 dhe në vitin 2015 me Ligjin Nr. 05/L009

Ky ligj e vendos kornizën ligjore për pronësinë e ndërmarrjeve publike (NP) dhe qeverisjen e tyre korporative në pajtim me praktikën e njohura ndërkombëtare, dhe si i tillë ka për synim krijimin e modaliteteve efektive të raportimit dhe llogaridhënies për mbikëqyrjen e NP-ve. Ligji përcakton se NP-të (përfshirë edhe KRU-të) janë të organizuara si Shoqëri Aksionare. KRU-të e klasifikuara si NP qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës dhe të drejtat pronësore ushtrohen nga Qeveria e Kosovës. Qeveria i përgjigjet dhe i jep llogari Kuvendit lidhur me arritjen e objektivave lidhur me KRU-të.

(iv) Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës

Me këtë ligj rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me resurset ujore dhe menaxhimin e tyre, duke përfshirë shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave si dhe financimin e menaxhimit të resurseve ujore. Sipas këtij ligji, “ndalohet, përveçse me leje ujore, shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në brigjet buzë lumit dhe tokave të lagëta⁵”.

2.2 Korniza Institucionale

Qeveria e Kosovës – Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNU)

Me qëllim të ushtrimit efektiv të përgjegjësisë të veta në sektorin e ujit, në vitin 2013, me Ligjin për Ujërat e Kosovës është themeluar Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNU) si organ vendimmarrës dhe mbikëqyrës i sektorit të ujërave si tërësi, i cili udhëhiqet nga Kryeministri dhe përbëhet nga katër ministra të linjës. KNU koordinon dhe mbështet institucionet përkatëse në menaxhimin e ujërave në procesin e vendimmarrjes dhe propozimin e masave për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore.

Ministria e Ekonomisë (ME)

ME është Ministri trashëgues e ish-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) e kjo e fundit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) që në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike i monitoron NP-të, përfshirë KRU-të dhe kompanitë e ujitjes, monitorim ky që bëhet përmes Njësisë për Politika dhe Monitorim dhe qëllimi i tij është që të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia në operimin e NP-ve. Ky ligj e definon kornizën ligjore që e rregullon ushtrimin e të drejtave pronësore ndaj NP-ve dhe rregullon parimet e qeverisjes korporative.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

MMPHI është themeluar në vitin 2002 si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (infrastruktura i është shtuar portfolios së kësaj Ministrie në vitin 2021) dhe është përgjegjëse për planifikimin e mjedisit përfshirë resurset ujore, mbeturinat, cilësinë e ajrit, menaxhimin e tokës, dhe planifikimin hapësinor. Kjo Ministri është po ashtu përgjegjëse për planifikim afatgjatë të resurseve ujore dhe për zhvillimin e strategjisë ujore të vendit.

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU)

⁵ Shprehja ‘toka të lagëta’ me gjasë është përdorur për ‘ligatina’ (përkthim tekstual i emrit ‘wetland’ nga gjuha angleze).

ARRU është rregullator i pavarur i shërbimeve të ujit përgjegjës për sigurimin e jodiskriminimit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore, eficiente, dhe të besueshme me çmime të drejta dhe të arsyeshme për konsumatorët duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik. ARRU i jep llogari Kuvendit të Kosovës që emëron drejtorin dhe zëvendësin e tij. ARRU jep licenca të shërbimit NP-ve që ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë, kanalizim, dhe ujë me shumicë; i përcakton tarifatat për këto shërbime dhe nxjerrë aktet nënligjore për licencimin, tarifatat, standardet e shërbimit, ndërprerjet e ujit.

Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të)

Të shtatë KRU-të⁶ iu ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizim pjesës më të madhe të popullatës në Kosovë. Ato janë nën pronësi publike të kontrolluara nga Qeveria e Kosovës përmes ME. KRU-të janë shoqëri aksionere me pronar të vetëm Republikën e Kosovës dhe janë të licencuara nga ARRU. Ato kanë marrëveshje të shërbimit me komunat ku ofrojnë shërbimet e veta e të cilat përshkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej palëve. KRU-të udhëhiqen nga Bordet e Drejtorëve të cilat emërohen nga Qeveria.

Komunat

Komunat sipas ligjit kanë kompetenca për ofrimin e shërbimeve e furnizimit me ujë, kanalizimit të ujërave të zeza dhe drenazhimit (kanalizimit atmosferik). Kompetencën e tyre për ofrimin e shërbimeve të ujës-jellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza komunat e kanë bartur tek KRU-të sipas legjislacionit për rregullimin e shërbimeve të ujit, ndërsa ofrimi i shërbimeve të drenazhit – kanalizimit atmosferik – është përgjegjësi e tyre (pra e komunave).

⁶ (i) KRU Prishtina ofron shërbimet e veta në komunat e rajonit të Prishtinës: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Shtimje, Glogoc dhe Graçanicë, (ii) KRU Hidroregjioni Jugor ofron shërbimet në komunat e rajonit të Prizrenit: Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash dhe Mamushë, (iii) KRU Hidrodrini ofron shërbimet në komunat e rajonit të Pejës: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, (iv) KRU Gjakova ofron shërbimet në komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe disa fshatra të komunës së Prizrenit, (v) KRU Mitrovica ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Vushtri dhe Skenderaj, (vi) KRU Hidromorava ofron shërbimet në komunat e rajonit të Gjilanit: Gjilan, Viti, Kamenicë, Novobërdë, (vii) KRU Bifurkacioni ofron shërbimet në komunat e rajonit të Ferizajt: Ferizaj, Kaçaniku dhe Hani i Elezit.

3. GJENDJA AKTUALE

Për gjendjen aktuale sa i përket kanalizimit atmosferik në Kosovë nuk ka të dhëna të disponueshme në formën e literaturës ose ndonjë raporti të përmbledhur. Sipas të gjitha gjasëve, kjo mungesë rezulton nga fakti se kanalizimi atmosferik nuk është trajtuar specifikisht me ndonjë akt ligjor (siç është bie fjala rasti me shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimin e ujërave të ndotura).

Prandaj, me qëllim të sigurimit të të dhënave për gjendjen ekzistuese në komuna sa i përket mbulimit me sistemin e kanalizimit atmosferik, gjendjes teknike të këtyre sistemeve si dhe aspekteve financiare dhe të menaxhimit të tyre, komunave iu është shpërndarë një pyetësor (shih Shtojcën 1). Këtij pyetësori i janë përgjigjur vetëm 20 komuna, kështuqë të dhënat në vazhdim e pasqyrojnë gjendjen ekzistuese sa i përket kanalizimit atmosferik në Kosovë bazuar në përgjigjet e këtyre 20 komunave.


3.1 Mbulimi i Zonës Urbane me Kanalizim Atmosferik

Sipas vlerësimit të komunave aktualisht 62.5% e sipërfaqes urbane në territorin e komunave mbulohet nga kanalizimi atmosferik.

Shkallën më të ulët të mbulimit e kanë komunat e Mamushës, Istogut (me nga 10%), Deçani e Gjlani (me nga 20%), Shtimja, Novobërda e Kamenica (me nga 30%), si dhe Vushtrria (45%). Ndërkaq të gjitha komunat tjera mbulimin e zonës urbane me kanalizim atmosferik e kanë me mbi 60%; mbulimin e plotë 100% e kanë komunat Mitrovica e Jugut, Drenasi, Hani i Elezit dhe Juniku, ndërsa 90% mbulueshmërinë e kanë komuna e Prishtinës, Skënderajt dhe Malishevës.

Pasqyra e plotë e mbulimit të zonës urbane me kanalizim atmosferik është dhënë në grafikonin në figurën 1 më poshtë.

Figura 1: Mbulimi i zonës urbane me kanalizim atmosferik



3.2 Vjetërsia dhe Gjendja e Kanalizimit Atmosferik

Nga bazë të përgjigjeve të komunave në pyetjen se kur është ndërtuar sistemi i kanalizimit atmosferik, mund të konstatohet se kanalizimi atmosferik në shumicën e komunave është relativisht i ri (kryesisht 10-20 vite i vjetër), dhe në gjendje relativisht të mirë/funksionale.

Kështu sa i përket vjetërsisë, në 14 prej 20 komunave, kanalizimi është jo më i vjetër se 20 vjet; në 4 komuna (Prishtinë, Gjakovë, Han i Elezit dhe Klinë) është deri 30 vjet dhe vetëm në dy komuna (Kamenicë dhe Mitrovicë) më i vjetër se 30 vjet.

Në tabelën 1 më poshtë janë paraqitur të përmbledhura të dhënat për vjetërsinë e kanalizimit atmosferik në komunat e Kosovës.

Tabela 1: Vjetërsia e kanalizimit atmosferik në komunat e Kosovës

Vjetërsia (vjet)	Komunat
< 10	7 komuna - Mamushë, Obiliq, Istog, Gjilan, Vushtrri, Malishevë, Deçan
10-20	7 komuna - Graçanicë, Shtime, Novobërdë, Skenderaj, Kaçanik, Glogoc, Junik
20-30	4 komuna - Han i Elezit, Gjakovë, Prishtinë, Klinë
> 30	2 komuna - Kamenicë, Mitrovicë e Jugut

Sa i takon gjendjes së kanalizimit atmosferik, sipas vlerësimit të komunave, ajo është përgjithësisht e mirë (5 komuna) ose funksionale (11 komuna). Vetëm 4 komuna e kanë vlerësuar gjendjen e kanalizimit atmosferik si të dobët dhe është interesant të theksohet se në 3 prej këtyre komunave (Novobërda, Shtimja dhe Skenderaj) kanalizimi është relativisht i ri (më pak se 20 vjet i vjetër). Asnjë komunë nuk e ka vlerësuar sistemin e kanalizimit atmosferik si shumë të keqe. Të dhënat e detajuara sipas komunave janë paraqitur në tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2: Gjendja e kanalizimit atmosferik në komuna

Gjendja	Komunat
E mirë	5 komuna - Klinë, Glogovc, Gjilan, Istog, Obiliq
Funksionale	11 komuna - Graçanicë, Mitrovicë e J., Vushtrri, Prishtinë, Gjakovë, Malishevë, Junik, Mamushë, Deçan, Kaçanik, Han i Elezit
E dobët	4 komuna - Kamenicë, Skenderaj, Shtime, Novobërdë
Shumë e keqe	

3.3 Mirëmbajtja e Kanalizimit Atmosferik

a) Shpeshhtësia e mirëmbajtjes

Shumica dërrmuese e komunave (13 prej 20) pohojnë se mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik e bëjnë sipas nevojës. Për dallim prej tyre, tri komuna (Prishtina, Vushtrria dhe Deçani) mirëmbajtjen e bëjnë 2 herë në vit, ndërkaq dy komuna (Obiliqi dhe Drenasi), 1 herë në vit.

Në dy raste komunat kanë dhënë përgjigje jotipike që paraqesin praktika të skajshme krahasuar me komunat tjera: (i) komuna e Istogut ka raportuar se ‘nuk ka pasur nevojë për mirëmbajtje’ – me gjasë pasi që kanalizimi atmosferik është i ri, dhe (ii) komuna e Mitrovicës së Jugut ka deklaruar se mirëmbajtjen e bën pas çdo reshje – rreth 10-20 herë në vit.

Duhet theksuar se mirëmbajtja ‘sipas nevojës’ paraqet mirëmbajtje reaktive, prandaj do të duhej të zbatohesh mirëmbajtje e rregulltë dhe sistematike e kanalizimit atmosferik (kontrollimi dhe pastrimi i ujëmbledhësve nga materiali i sedimentuar, kontrollimi dhe pastrimi i tubacioneve, kontrollimi dhe riparimi i pusetave dhe elementeve tjera të sistemit).

b) Organizimi i mirëmbajtjes

Në tabelën më poshtë është dhënë një pasqyrë për atë se si është e organizuar mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik nëpër komuna.

Tabela 3: Forma e organizimit të mirëmbajtjes së kanalizimit atmosferik nëpër komuna

Mirëmbajtja kryhet nga:	Komunat
Operatori privat	Kaçanik, Gllogovc, Mamushë, Prishtinë, Shtime, Han i Elezit, Skenderaj
KRU	Istog, Junik
KRM	Deçan, Gjakovë
Ndërm. komunale	Vushtrri, Obiliq
Nuk ka	Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Klinë, Malishevë, Kamenicë

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, një numër i konsiderueshëm i komunave – 7 sish – kanë kontrata me operatorë privat për mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik. Komunat tjera ose nuk kanë kontratë fare (Mitrovica, Novobërda, Klina dhe Kamenica), ose mirëmbajtjen e kryejnë përmes (i) Ndërmarrjes Publike Lokale (Vushtrria dhe Obiliqi), (ii) Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (Gjakova dhe Deçani), apo (iii) e trajtojnë si përgjegjësi të KRU-së (Istogu dhe Juniku).


3.4 Resurset Financiare dhe Njerëzore të Komunave për Menaxhim të Kanalizimit Atmosferik

a) Resurset financiare

Sa i përket buxhetit komunal për menaxhimin e sistemit të kanalizimit atmosferik, situata dallon dukshëm nga komuna në komunë. Buxheti komunal që ndahet për këtë qëllim variron prej 0 deri në 150 mijë EUR. Gjashtë komuna kanë raportuar se nuk ndajnë buxhet fare për menaxhimin e kanalizimit atmosferik (dy prej tyre me justifikimin se mirëmbajtja është obligim i KRU), ndërsa në disa raste komuna nuk ka kod të veçantë buxhetor për kanalizimin atmosferik dhe mjetet për këtë destinim janë në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të drejtorisë komunale, apo në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve, shtretërve të lumenjve etj.

Përqindja e buxhetit komunal i ndarë për menaxhimin e kanalizimit atmosferik, bazuar në informatat e siguruara nga KRU-të është paraqitur në grafikun më poshtë.

Figura 2: Përqindja e buxhetit komunal që ndahet për menaxhimin e sistemit të kanalizimit atmosferik



Siç mund të shihet nga grafiku, në përgjithësi, ose (i) nuk ka fare ndarje (kod) për menaxhimin e kanalizimit atmosferik, ose (ii) mjetet janë në përqindje shumë të vogël.


b) Resurset njerëzore (stafi)

Sipas të dhënave të ofruara nga komunitat, numri i stafit që ka komunitat për punët e kanalizimit atmosferik shkon prej 0 (Juniku, Malisheva, Gjakova, Shtimja, Istogu dhe Kamenica) deri në 5 (Klina dhe Mitrovica e Jugut). Komunitat tjera kanë prej 1 deri në 3 punonjës që merren me punët e menaxhimit të kanalizimit dhe atë janë kryesisht menaxher të kontratave dhe menaxher të projekteve.

Vlen të theksohet rasti i komunës së Gjilanit që ka raportuar se ka 2 inxhinierë të hidroteknikës të cilët meren me problemet e kanalizimit si dhe rasti i komunave të Junikut dhe Istogut që mungesën e personelit për menaxhimin e kanalizimit atmosferik ia atribuojnë faktit se kjo është përgjegjësi e KRU Hidrodrini.

Në figurën më poshtë janë paraqitur në formë grafike të dhënat për personelin e komunave në menaxhimin e kanalizimit atmosferik.

Figura 3: Numri i punonjësve të komunës për menaxhimin e kanalizimit atmosferik



3.5 Njohuritë e Komunave për Përgjegjësinë e tyre për Menaxhimin e Kanalizimit Atmosferik

Nga të dhënat e ofruara prej komunave mund të shihet se shumica e komunave janë në dijeni për përgjegjësinë e tyre për menaxhimin e kanalizimit atmosferik. Janë vetëm 3 (Mamusha, Gjakova dhe Shtimja) nga 20 komunat që kanë deklaruar se stafi i tyre përgjegjës nuk është në dijeni për faktin se menaxhimi i kanalizimit atmosferik është përgjegjësi e komunës.

Përpos tyre janë edhe 2 komuna (Istogu dhe Juniku) të cilat pretendojnë se kjo përgjegjësi i takon KRU-ve, në rastin e tyre KRU Hidrodrini. Në anën tjetër, komuna e Vushtrrisë pohon se stafi i komunës është deri diku është i njofuar për përgjegjësinë që ka komuna për menaxhimin e kanalizimit atmosferik, ndërkaq komuna e Klinës nuk ka dhënë përgjigje në këtë pyetje.

3.6 Bashkëpunimi me KRU

Më shumë se gjysma e komunave (11 nga 20 sish) kanë bashkëpunim me KRU për menaxhimin e kanalizimit atmosferik, qoftë në bazë të marrëveshjes apo me kërkesa të veçanta sipas nevojës.

Komunat tjera (9 sish) pohojnë se bashkëpunojnë me KRU vetëm për kanalizimin e ujërave të ndotura (kanalizimin fekal), apo në rastet e kanalizimit të kombinuar (komuna e Prishtinës). Prej këtyre, 2 komuna (Obiliqi dhe Vushtria) i kanë ndërmarrjet komunale, të tjerat kanë operatorë privat apo e kryejnë mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik përmes KRM (rasti i komunës së Gjakovës).

Një pasqyrë përmbledhëse e bashkëpunimit të komunave me KRU sa i përket mirëmbajtjes së kanalizimit atmosferik është paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 4: Bashkëpunimi i komunave me KRU në mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik

Bashkëpunimi me KRU	Komunat	Koment
Po (11 komuna)	Klina	
	Kaçaniku	
	Juniku	Marrëveshje me KRU
	Mamusha	
	Shtimja	Sipas nevojës
	Skenderaj	
	Istogu	
	Kamenica	Sipas nevojës – pas intervenimit të KRU, komuna pagan
	Mitrovica e J. Malisheva Hani i Elezi	
Jo (9 komuna)	Drenasi/Gllogovci	Vetëm për kanalizimin fekal
	Mamusha	
	Gjakova	
	Prishtina	Vetëm në rastet e kanalizimit të kombinuar
	Gjilani	
	Novobërda	
	Obiliqi	Vetëm për kanalizim fekal
	Vushtrria	Me kontraktorët e mirëmbajtjes së kanalizimit atmosferik
Graçanica	Vetëm për kanalizim fekal	

3.7 PROBLEMET KRYESORE LIDHUR ME MENAXHIMIN E KANALIZIMIT ATMOSFERIK

Disa prej problemeve kryesore të identifikuara lidhur me menaxhimin e kanalizimit atmosferik janë si vijon:

1. Mungesa e legjislacionit që to të rregullonte qartë dhe në mënyrë të detajuar menaxhimin e kanalizimit atmosferik në kuptim të përgjegjësiave ligjore për planifikimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tij si përfshirë edhe rregullimin e problemit të kyçjeve shtëpiake në sistemin e kanalizimit (ndalimin e

shkarkimit të ujërave atmosferike në sistemin e kanalizimit fekal dhe anasjelltas, ndalimin e shkarkimit të ujërave fekale në sistemin e kanalizimit atmosferik).

2. Mungesa e standardeve teknike dhe rregulloreve për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik që do ndihmonte në cilësinë e projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të kanalizimit atmosferik dhe do të promovonte zbatimin e metodave dhe praktikave që bazohen në zhvillimet shkencore dhe inxhinierike të fushë.
3. Disa prej komunave nuk janë në dijeni për përgjegjësinë e tyre lidhur me menaxhimin e kanalizimit atmosferik, dhe e konsiderojnë menaxhimin e kanalizimit atmosferik si përgjegjësi të KRU-ve.
4. Sistemi i kanalizimit atmosferik dhe ai i ujërave të ndotura në shumë raste nuk janë të ndarë po janë të përzier. Kjo veçanërisht rezulton nga kyçjet e palejueshme të ujërave atmosferike në rrjetin e kanalizimit të ujërave të ndotura dhe anasjelltas. Komunitat nuk zbatojnë efektivisht inspektimin dhe moslejimin e këtyre kyçjeve që janë të ndaluara⁷ dhe që kanë efekte negative në mjedis⁸ dhe në trajtimin e ujërave të ndotura⁹.
5. Mungesa e të dhënave të detajuara dhe të plota për sistemin e kanalizimit atmosferik në territorin e komunave (dimensionet, gjatësitë, materialet, koordinatat gjeografike), përfshirë ujëmbledhësit, kanalet e hapura dhe sistemin e tubacioneve.
6. Komunitat nuk kanë dokumente planifikuese (strategji, masterplan) për zhvillimin e kanalizimit atmosferik që do të ishte i ndërlidhur me planet urbane e që do të inkorporonte edhe vizionin e zhvillimit urban me zgjidhje të duhura mjedisore për kullimin e sipërfaqeve publike dhe largimin e ujërave atmosferike e që mundësojnë infiltrim më të madh të reshjeve dhe ripërdorim të ujërave atmosferike.
7. Mungesa e kapaciteteve financiare dhe profesionale tek komunitat për menaxhimin e kanalizimit atmosferik. Shumica e komunave nuk kanë buxhet

⁷ Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për Mënyrat, Kushtet, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujor - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=58967>.

⁸ Kur ujërat e ndotura shkarkohen në kanalet/tubacionet e ujërave atmosferike.

⁹ Kjo ndodhë kur ujërat atmosferike nga objektet e banimit ose ato afariste shkarkohen në kanalizimin e ujërave të ndotura dhe kështu ngarkojnë kostot e trajtimit të ujërave të ndotura, respektivisht afektojnë kapacitetin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.

të ndarë specifikisht për mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik, dhe në anën tjetër as kapacitete profesionale për një menaxhim efikas të kanalizimit atmosferik si dhe nuk kanë resurse njerëzore të nevojshme për menaxhimin dhe zbatimin inspektues të rregullave për kanalizimin atmosferik.

4. POLITIKA E REKOMANDUAR

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka për mirëqenien publike dhe për mjedisin, menaxhimi i kanalizimit atmosferik duhet të ushtrohet nga komunat konform përgjegjësisë ligjore që kanë.

Bazuar në problemet e identifikuara, për menaxhimin e duhur dhe efektiv të kanalizimit atmosferik në Kosovë rekomandohet si vijon:

- 1) Rritja e kapaciteteve profesionale dhe financiare të komunave për menaxhimin e kanalizimit atmosferik në përputhje me përgjegjësinë ligjore që kanë, përfshirë planifikimin, ndërtimin/zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rregulltë vjetore të kanalizimit atmosferik;
- 2) Krijimi i një mjedisi mundësues që përfshinë zhvillimin e kuadrit rregullator dhe institucional si dhe alokimet e nevojshme buxhetore për komunat për të mbështetur menaxhimin efektiv të kanalizimit atmosferik.

Menaxhimi i ujërave atmosferike ka efekte të shumëfishta në: cilësinë e ujërave/lumenjve ku shkarkohen ato, erozionin, përmbytjet urbane, dhe në ciklin hidrologjik natyror.

Për të përmbushur efektivisht përgjegjësinë ligjore që kanë komunat duhet të angazhohen për krijimin e resurseve të nevojshme profesionale dhe financiare, dhe në këtë drejtim të ndërmarrin veprimet si vijon:

- a) Komunat duhet ta njohin dhe ta ushtrojnë plotësisht përgjegjësinë e tyre për menaxhimin e kanalizimit atmosferik.
- b) Për menaxhimin e sistemit të kanalizimit atmosferik komunat do të duhej të bëjnë para së gjithash inventarizimin (kompletimin e të dhënave) e objekteve ekzistuese të këtij sistemi (kanalet e hapura, tubacionet, ujëmbledhësit, pusetat etj.). Kjo do të duhej të bëhej preferueshëm në formë digjitale.
- c) Mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik komunat do të duhej ta (i) kontraktojnë me operator privat ose KRU, ose (ii) ta zbatojnë përmes një kompanie komunale (KRM ose kompani tjetër).
- d) Për kostot e mirëmbajtjes dhe operimit të kanalizimit atmosferik komunat duhet ta planifikojnë rregullisht buxhetin vjetor.

- e) Për mbulimin e funksioneve të mbikëqyrjes administrative, profesionale dhe inspektuese që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sistemit të kanalizimit atmosferik, komunat do të duhej të kenë personel të kualifikuar nga fusha juridike, inxhinierike dhe inspektuese.
- f) Në një afat të shkurtër komunat do të duhej të hartojnë planet e zhvillimit të kanalizimit atmosferik të cilat duhet të jenë të harmonizuara me planet urbane të komunës dhe të cilat inkorporojnë praktikën e mira të ‘zgjidhjet e bazuara në natyrë¹⁰’ me qëllim të maksimizimit të përfitimeve sociale dhe mjedisore (si.sh. planifikimi i sipërfaqeve publike që mundësojnë infiltrimin e reshjeve¹¹, krijimi i baseneve të retencionit¹² etj.).

Në anën tjetër, për krijimin e mjedisit të duhur mundësues që do ta lehtësonte ndërmarrjen e veprimeve të mësipërme nga ana e komunave, rekomandohet që:

- a) **të hartohet një udhëzues nacional për menaxhimin e ujërave atmosferike** që do të përfshinte:
- (i) aspektet planifikuese dhe teknike si:
- adoptimin e praktikave më të mira të planifikimit dhe menaxhimit të ujërave atmosferike që përfshijnë ‘zgjidhjet e bazuara në natyrë’ si p.sh. ‘qytetet shpuzë¹³’,
 - standardet e projektimit dhe ndërtimit të kanalizimit atmosferik, dhe
- (ii) aspektet administrative dhe menaxhuese si:
- modalitetet e menaxhimit të kanalizimit atmosferik nga ana e komunave përmes kontraktimit me operatorë privat apo KRU,
 - rregulloret komunale për mirëmbajtjen dhe inspektimin e sistemit të kanalizimit atmosferik;

¹⁰ ‘Nature Based Solutions’ – intervenime që shfrytëzojnë funksionet natyrore të ekosistemeve për mbrojtjen e mjedisit dhe që ndihmojnë menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.

¹¹ Si p.sh. hapësira publike të gjelbërta dhe me porozitet për dallim prej asfaltit dhe betonit që nuk lejon infiltrimin e ujit.

¹² Basene që ndalin ujërat atmosferike me qëllim që të parandalojnë përmbytjet urbane si dhe mundësojnë pastrimin e ujërave atmosferike para shkarkimit të tyre në lum.

¹³ Model i planifikimit urban i inicuar së pari në Kinë e që po aplikohet edhe në vende tjera (p.sh. ne Berlin, Los Angeles etj.). Ky koncept bazohet në krijimin e kushteve për ndalimin natyral të ujit të reshjeve, mundësimin e infiltrimit të tij në tokë dhe rrjedhimisht edhe pastrimin e tij.

- procedurat standarde të mirëmbajtjes së kanalizimit atmosferik etj.

Këta udhëzues do të mund të hartoheshin nga **MMPHI** (pjesa që ka të bëjë me aspektet planifikuese dhe teknike), dhe **komunat** përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës (pjesa që ka të bëjë me aspektet administrative dhe planifikuese).

- të përfshihen me Rregulloret Komunale për Shërbime Publike** të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik;
- gjatë procesit të dhënies së lejes së ndërtimit të lejeve mjedisore komunale të përcaktohet shkarkimi i ujërave atmosferike** – në rrjetin e kanalizimit atmosferik aty ku ka, apo të bëhet zgjidhja teknike aty ku nuk (natyrisht nuk lejohet shkarkimi i ujërave atmosferike në kanalizimin fekal);
- Të zbatohet përmes inspektionit komunal identifikimi dhe moslejimi i kycjeve** të kanalizimit fekal në rrjetin e kanalizimit atmosferik dhe anasjelltas, shkarkimi i ujërave atmosferike në sistemin e kanalizimit fekal (të ujërave të ndotura).

Referencat

- 1) Kuvendi i Kosovës (2008). Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>;
- 2) Kuvendi i Kosovës (2016). Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11350>;
- 3) MMPHI (2022). Udhëzimi Administrativ për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujëave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujor - [ActDetail.aspx.pdf \(rks-gov.net\)](#);
- 4) Qeveria e Kosovës (2023). Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025, Prishtinë - https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/2023_0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf.
- 5) SachsenWasser & AHT with Hidroing (2019). Koncepti për O&M të Ujerave Atmosferik për Pejën.

SHTOJCA: PYETËSORI I MENAXHIMIT TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK

Pjesa 1: Informata të përgjithshme

1. Emri i Komunës: _____
2. Popullsia urbane e komunës (përafërt): _____
3. Sipërfaqja urbane e komunës (në km²): _____
4. Mbulimi i zonës urbane me kanalizim atmosferik (%): _____

Pjesa 2: Menaxhimi aktual i kanalizimit atmosferik

5. Përshkruani gjendjen aktuale të kanalizimit atmosferik të komunës suaj:
 - a. Sa është vjetërsia mesatare e kanalizimit atmosferik?

[10 vjet, 10-20 vjet, 20-30 vjet, >30 vjet]
 - b. Çfarë është gjendja e kanalizimit atmosferik?

[e mirë, funksionale, e dobët, shumë e keqe]
6. Sa shpesh bëhet mirëmbajtja e kanalizimi atmosferik?

[më rallë se 1 herë në vit, 1 herë në vit, 2 herë në vit, sipas nevojës]
7. A ka komuna kontratë për mirëmbajtje të kanalizimit atmosferik? Nëse po, a është kontrata me Kompaninë Rajonale të Ujit (KRU) apo ndonjë kontraktor tjetër? Nëse jo, kush e mirëmban _____ kanalizimin _____ atmosferik?

8. Cilat janë sfidat kryesore të komunës për mirëmbajtjen e kanalizimi atmosferik? (p.sh., kufizimet financiare, infrastruktura e vjetërsuar, mungesa e stafit)

- a. _____
- b. _____

Pjesa 3: Burimet financiare dhe njerëzore

9. Sa është buxheti vjetor i komunës për menaxhimin e kanalizimit atmosferik?:

[EUR]

Menaxhimi i kanalizimit atmosferik në Kosovë

10. Sa përqind të buxhetit të komunës suaj përbën kjo?: _____
[%]

11. Sa personel (punonjës) të komunës janë të angazhuar/ngarkuar për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik?

12. Cilat janë sfidat kryesore të komunës për financimin e menaxhimit të kanalizimit atmosferik?

a.

b.

c.

Pjesa 4: Njohuritë dhe kapacitetet e komunës

13. A është i njohtuar stafi përgjegjës i komunës për përgjegjësinë që ka komuna lidhur menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik?

14. A ka pasur ndonjë program trajnimi apo ngritjeje të kapaciteteve në lidhje me menaxhimin e kanalizimit atmosferik? (Nëse po, ju lutemi jepni detaje).

Pjesa 5: Bashkëpunimi dhe mbështetja

15. A bashkëpunon aktualisht komuna juaj me KRU-të dhe organizatat e tjera relevante në menaxhimin e kanalizimit atmosferik? (Nëse Po, ju lutemi jepni detaje).

16. Cila formë e mbështetjes do të ishte më e dobishme nga qeveria apo subjektet e tjera për përmirësimin e menaxhimit të kanalizimit atmosferik të komunës tuaj? (p.sh., asistencë financiare, trajnim teknik, investime në infrastrukturë)

Pjesa 6: Sfidat dhe nevojat

17. Cilat janë pengesat kryesore me të cilat përballlet komuna juaj në menaxhimin efektiv të kanalizimit atmosferik?

18. Cilat fusha specifike të menaxhimit të rrjetit të kullimit dëshironi të përmirësoni ose zgjeroni?

Pjesa 7: Politikat dhe rregulloret

19. A ka ndonjë politikë ose rregullore ekzistuese që ndikojnë në punën tuaj për të menaxhuar në mënyrë efektive kanalizimin atmosferik? (Nëse po, ju lutemi përshkruani).

20. Çfarë ndryshimesh apo ndërhyrjesh do të rekomandonit për të përmirësuar menaxhimin e rrjetit të kullimit në nivel komunal?

Pjesa 8: Komente shtesë

21. Ju lutemi jepni çdo koment ose sugjerim shtesë që mendoni se është i rëndësishëm për zhvillimin e politikave efektive të menaxhimit të kanalizimit atmosferik.



**Funded by
the European Union**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Rilindja Gjellbër (is Let’s Do It Peja).

Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Rilindja Gjellbër

Adresa: Shtëpia e Kulturës, kati III

30000, Pejë, Kosovë

Email: info@rilindja-gjelber.org

Tel: +383 49 124 548

www.puacw.ldip.com



Promoting Universal
Access to **Clean Water**